



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 02 korrik 2018, në mbledhjen e III-të (tretë,) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Bashkim Sylja, Shaban Ahmeti, Valmire Lahu, Albina Avdiu, ndërsa munguan, Radisav Perović dhe Mefail Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Nexhmedin Feta, Policia Kufitare, Fadil Babatinca Policia e Kosovës, dhe Angela Magera KFOR - LMT.

Miratimi i rendit të ditës

z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të rendit të propozuar të ditës. Meqë nuk pati diskutim rreth rendit të ditës, kryesuesi e hedh në votim.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22 maj 2018

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, fillimisht një sqarim, kërkoj të korrigjohet teksti i kësaj pike sepse siç shihet figuron fjala “inauguruese” e që në fakt mbledhja inauguruese është mbajtur më 23 prill 2018, pra të fshihet fjala “inauguruese”.

Po ashtu në mbledhje e kaluar ka qenë pikë e rendit të ditës raporti i punës së ZKKK për vitin 2017, edhe përkundër që ai raport ju është dërguar anëtarëve të këtij Komiteti, unë në pika të shkurtra edhe e kam prezantuar në atë mbledhje si dhe kam dhënë sqarime dhe përgjigje të ndryshme, mirëpo në faqen 3 të Ekstraktit të procesverbalit, në një pjesë të diskutimit tim unë kam thënë diçka tjetër në krahasim me atë që thuhet në procesverbal, mund të jem gabim ndoshta unë por realiteti është si në vijim:

“Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me OJQ-të “Qëndrimi” dhe “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve” përmes organizimit të mësimin intensiv plotësues për nxënësit e shkollave fillore nga klasa e parë deri në të nëntën, ku funksionojnë dy klasë, njëra ka 41 nxënës dhe funksionon në shkollën “Dr Ibrahim Rugova”, dhe njëra në lagjen “Ali Ajeti” e cila ka 44 nxënës, klasë këto të cilat vijnë në mësimin në dy ndërrime, program ky i cili mbështetet edhe nga Drejtorja e

Arsimit dhe normal financohet nga OJQ "Voice of Roma" e që në bashkëpunim dhe në koordinim me OJQ-në "Qëndrimi" janë formuar paralelet e cekura ku janë 4 mësimdhënës". Andaj kërkoj të përmirësohet teksti i fjalisë së cekur.

Njëzëri u miratua, duke përfshirë korrigjimin e një pjese të diskutimit të z.Liman Zeqirit, në faqen 3, përkatësisht pas fjalisë ".....dhe të gjithë marrin bursa nga OJQ "Vois of Roma" duhet të jetë, si vijon;

"Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me OJQ-të "Qëndrimi" dhe "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve" përmes organizimit të mësimin intensiv plotësues për nxënësit e shkollave fillore nga klasa e parë deri në të nëntën, ku funksionojnë dy klasë, njëra ka 41 nxënës dhe funksionon në shkollën "Dr Ibrahim Rugova", dhe njëra në lagjen "Ali Ajeti" e cila ka 44 nxënës, klasë këto të cilat vijnë mësimin në dy ndërrime, program ky i cili mbështetet edhe nga Drejtorja e Arsimit dhe normal financohet nga OJQ "Voice of Roma" e që në bashkëpunim dhe në koordinim me OJQ-në vendore "Qëndrimi" janë formuar paralelet e cekura ku janë 4 mësimdhënës".

Ndërsa pjesa tjetër mbetet siç është.

2. Informatë për vizitën e anëtarëve të Komitetit për Komunitete në shkollat e fshatrave Batllavë dhe Orllan, si dhe vizitën në fshatin Metergoc (Lagja Sekiraqa), realizuar më 18 qershor 2018.

z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj vizite, ne kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe e kemi përfshirë edhe në planin e punës për vitin 2018. Gjatë kësaj vizite kemi biseduar me drejtor të shkollave të fshatrave Batllavë dhe Orllan, bisedë kjo e cila është fokusuar kryesisht rreth gjendjes, numrit dhe nevojave tjera të nxënësve të komuniteteve në ato lokalitete. Për më shumë fjalën ja jap znj.Doruntina Hasanit.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, gjatë vizitës në shkollën "Luigj Gurakuqi" në fshatin Batllavë kemi pasë takim me z.Ismet Jasharin, drejtor i asaj shkolle ku kryesisht kemi bashkëbiseduar për gjendjen e nxënësve të Komunitetit RAE, ku numri i nxënësve është si në vijim, në mësimin parafillorë ishte një nxënëse femër, në klasën e dytë ishte po ashtu një nxënëse femër, në klasën e pestë ishte një nxënës mashkull, në klasën e gjashtë ishin dy nxënës femra të cilët vijnë mësimin në atë shkollë.

Pastaj në vizitën e bërë në shkollën "Zahir Pajaziti" në fshatin Orllan, po ashtu kemi bashkëbiseduar me drejtorin e shkollës z.Zijadin Zeqiri, i cili na informoj rreth gjendjes dhe vijueshmërisë së nxënësve të komunitetit RAE.

Mandej kemi vizituar edhe fshatin Metergoc, përkatësisht lagjen e Sekiraqa ku jeton anëtari i këtij Komiteti nga radhët e Komunitetit serb, me të cilin kemi diskutuar dhe kemi parë gjendjen e tij nga afër, dhe nga i cili janë vënë disa kushte në formë të kërkesave.

z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket kushteve të kërkuara nga përfaqësuesi i komunitetit serb, janë kushte të cilat nuk janë në kompetencë të Komitetit për Komunitete dhe nuk mund t'i realizojmë ato. Ne realisht i dënojmë rastet e tilla ku i është thyer dhe vjedhur shtëpia e atij personi çka edhe kërkojmë të ndërmerren masa nga organet e rendit. Konsideroj se një akt i tillë mund t'i ndodh secilit prej neve pa dallime po qe se e mbyllim shtëpinë rreth 1 muaj dhe shkojmë ndokund. Unë edhe në bashkëbisedim i thash që ne nuk mund të sigurojmë roje për shtëpinë tënde sepse jo që nuk kemi

dëshirë, por nuk kemi kompetenca dhe mekanizma për një gjë të tillë, si dhe nuk konsideroj se është një gjendje e tillë ku duhet të sigurohet ndonjë shtëpi e ndokujt, kushdo qoftë dhe i cilit do komunitet qoftë, por janë gjëra që mund t'i ndodhin çdo kujt, dhe çdo shtëpie të familjeve të secilit komuniteti, gjë për të cilën ishte i pajtimit edhe vet personi në fjalë. Përndryshe ishte një pritje e mirë nga ana e përfaqësuesit të komunitetit serb i cili është edhe anëtarë i këtij Komiteti.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, ne edhe para kësaj mbledhje, patëm një takim me përfaqësues të MAPL-së ku një çështjet që u diskutuan ishte edhe integrimi i Komuniteteve, ku nga ai takim rezultojë se Komuna e Podujevës ka një vlerësim pozitiv, gjë të cilën e kam thënë edhe më parë në mbledhje të Komitetit për Komunitete. Në Komunën e Podujevës sistemi shkollorë zhvillohet në një gjuhë që është gjuha Shqipe si gjuhë unike, edhe pse ka nxënës të komunitet RAE, të gjithë vijnë në mësimet në gjuhën shqipe, pa dashur të nënkuptohet se ka ndarje sepse nuk ka pasur asnjëherë, përkundrazi ne gjithëherë kemi jetuar bashkërisht, për çka edhe mburrem sepse nuk ka ndonjë dallim e që konsideroj se nuk vie në shprehje dhe nuk mund të paramendohet edhe në të ardhmen, por çdo herë është në gjendjen më të mirë të mundshme, përveç asaj që ne qoftë si ZKKK, qoftë si Drejtori, qoftë si Komunë në përgjithësi, çdo herë duhet ta kemi parasysh bashkëjetesën e cila luan një rol jashtëzakonisht të mirë në shoqëri, (madje e kam cekë edhe më parë se ne jemi edhe gjematë të përbashkët), andaj është mirë që nuk ka ndarje askund në asnjë aspekt në territorin e Komunës së Podujevës por kemi shkolla të përbashkëta, është sistem unik dhe nuk kemi asnjë problematikë rreth kësaj çështjeje, e që është shumë me rëndësi për një shoqëri. Ne realizuam vizitat e cekura, është mirë që ne u njoftuam edhe me gjendjen faktike, mburrem me atë që bashkëjetojmë dhe kemi anë pozitive sa i përket nxënësve të të gjitha komuniteteve gjatë procesit mësimor, pastaj edhe bashkëjetesës së të gjithë qytetarëve në përgjithësi. Sa i përket vizitës në lagjen Sekiraga në fshatin Metergoc, përkatësisht tek anëtar i këtij Komiteti z.Radisav Perović, ne ishim prezent aty dhe de fakto dhe de jure për disa çështje që u diskutuan në atë vizitë, Komiteti për Komunitete nuk pranon akte të tilla, prona është e shejtë, pavarësisht e kujt është nuk pranojmë që prona të shkatërrohet, të cenohet apo të uzurpohet, çështje këto të cilat janë të ndjeshme. Ne mund të themi se janë organet kompetente shtetërore të cilat merren me çështje të tilla, siç janë Prokuroria, Policia, organet që merren me menaxhimin e pyjeve e që është Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, çështje të cilën personi në fjalë mund ta ngritë në ato organe gjegjëse. Ne edhe në takim shprehëm keqardhje për dëmtimin e pronës, gjë që është e palejueshme, e pa pranueshme, dhe si Komitet nuk e pranojmë këtë dhe asnjëri prej nesh nuk është ndier mirë nga rasti në fjalë, por janë çështje të cilat mund dhe ju ndodhin të gjithëve ku dikujt i shkatërrohet pylli, dikujt prona, dikujt shtëpie etj të ngjashme, gjëra të cilat neve nuk na bëjnë mirë. ne çdo herë jemi që të gjithë qytetarët ta gëzojnë të drejtën e tyre në të gjitha aspektet qoftë në pronë, lëvizje të lirë, punësim etj, andaj e them se për çështje të tilla që pothuajse janë të ndjeshme kompetente janë organet tjera.

z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë u thanë të gjitha rreth vizitave të realizuara, unë e mbylli këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht informatën rreth vizitave të lartcekura,

3. Të ndryshme

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, jeni në dijeni se Komuna është në proces të hartimit dhe përgatitjes së projekt buxhetit për vitin 2019 dhe prioritetet për vitet 2020/2021 dhe nuk jam dijeni se a janë përfshirë në dokumentin fillestar që ka qenë KAB 2019/2021 edhe kërkesat për rregullim të infrastrukturës, ambientit etj të ngjashme, të lagjeve ku jetojnë Komunitetet jo shumicë, gjë për të cilën mund të na njoftojnë edhe këshilltarët e Kuvendit të cilët janë prezent këtu, mirëpo sa jam në dijeni deri në miratimin përfundimtarë është edhe një rishqyrtim i dokumentit përkatës, andaj dëshiroj t'ju bëjë

thirrje përfaqësuesve të lagjeve ku jetojnë Komunitetet, të parashtrojnë kërkesat e tyre. Arsyeja përse e them këtë është se vitet e kaluara ka qenë paksa më problematike kjo çështje sepse për një rrugë është dashur që vetë banorët ta hartojnë projektin, i cili natyrisht ka një kosto, si dhe përveç kësaj ka qenë edhe çështja e participimit nga vetë banorët e lokaliteteve, tani është më lehtë sepse nga viti i kaluar është hequr forma e participimit dhe ajo e hartimit të projekteve nga vet banorët e lokaliteteve përkatëse e që në të kaluarën ka pas raste ku komunitetet nuk kanë pasë mundësi të participojnë në projekte dhe të hartojnë projekte të ndryshme infrastrukturore, edhe përkundër asaj që i kemi ndihmuar në projekte të ndryshme por gjithnjë duke dhënë arsye të qarta se nuk kanë mundësi financiare, ndërsa tani në këto rrethana kur ne po diskutojmë është mirë që të gjitha ato vendbanime ku jetojnë Komunitetet jo shumicë, siç janë lagjet ‘‘Ali Ajeti’’, ‘‘Xhafer Meta’’, ato në fshatrat Peran, Orllan, Batllavë, Sfeçël, Metergoc e të tjera, të bëjnë kërkesat e tyre përmes arhivës, t’iu drejtohen organeve - Drejtorive përkatëse në mënyrë që të përfshihen në propozim buxhet i cili do të shqyrtohet në muajin shtator, e që natyrisht këtu janë edhe këshilltarët e Kuvendit të cilët mund të mbështesin dhe t’i arsyetojnë kërkesat e tilla. Sa jam në dijeni kërkesat e Komunitetit jo shumicë janë për asfaltim të disa rrugicave.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, patjetër që asfaltimi i rrugicave janë të nevojshme dhe të arsyeshme, por do të thoja që mund të ketë edhe ndonjë projekt i cili do të sensibilizonte fëmijët e komuniteteve që të regjistrohen dhe të vijojnë shkollimin sa më shumë prej tyre. Pra ideja është që të bëhet diçka kreative, qoftë me ndonjë video apo të ngjashme, dhe natyrisht se ndihma jonë, qoftë si anëtarë të këtij Komiteti qoftë si këshilltarë të Kuvendit, nuk do të mungoj.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, fjala ishte rreth infrastrukturës, por natyrisht që edhe projekte tjera janë shumë të rëndësishme, qoftë arsimi, shëndetësia dhe të gjitha fushat tjera, siç ishte ajo që parafolësja e ceku, gjë e cila është paraparë edhe në Planin e veprimit sikurse që janë edhe projekte të tjera me rëndësi.

z.Bashkim Syla, theksoi, konsideroj se Kryesuesi i këtij Komiteti ka informata më të shumta se ne sa i përket nevojave dhe prioriteteve të Komuniteteve, por edhe anëtarët tjerë të Komuniteteve që janë në këtë Komitet, andaj do të ishte mirë që të njoftohemi ne këshilltarët e Kuvendit me kërkesat dhe prioritetet e Juaja në mënyrë që ne pastaj do të mund t’i paraqesim në Kuvend.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, kërkesat natyrisht që bëhen në vijë institucionale, dhe e udhës do të ishte që të parashtrohen nga vetë përfaqësuesit e lagjeve përkatëse, pastaj ne si ZKKK, dhe Ju si këshilltarë të Kuvendit mund të kontribuojmë në përfshirjen e tyre në projekt buxhet.

z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj z.Liman Zeqirin dhe këshilltarët e Kuvendit për përkrahjen e tyre në funksion të realizimit të kërkesave të Komuniteteve. Ne pa dyshim se do të punojmë në këtë drejtim. Gjithashtu në planin e punës e kemi të paraparë edhe vizitë në ndonjë Komitet në ndonjë Komunë të Kosovës, andaj ditëve në vijim do të të bisedojmë për një vizitë të tillë me qëllim që të shohim se si funksionojnë Komitetet për Komunitete edhe në Komunat tjera.

Kryesuesi përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 11.35’

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0052340/18

Podujevë,

02 korrik 2018

Kryesuesi i Komitetit

Shaban Ahmeti